



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



Një Ujë - Një Shëndet
UBT sjell ekselencën kërkimore në
dialogun global për ujin dhe
shëndetin

Në forumin global në Singapor, Prof. Dr. Erinda Lika, Zv/rektore për Shkencën dhe Projektet në UBT, përfaqësoi UBT në workshop-in "Rimendimi i Ujit dhe Shëndetit: Integrimi i konceptit One Water dhe One Health"

Lexo në faqen 3

UBT workshope intensive
për programet e reja

Përgjatë gjithë muajit qershor, Universiteti Bujqësor i Tiranës zhvilloi një seri workshop-esh intensive, të organizuara pothuajse çdo ditë, në kuadër të procesit të sigurimit të cilësisë në implementimin e programeve të reja, në kuadër të reformimit të ofertës akademike UBT-BOKU 2030, për vitin e ri akademik.

Workshop-et u organizuan nga Zv Rektori për mësimin Prof. Dr. Ilir Kapaj, Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë në UBT (DVBSC) dhe koordinatorët e programeve të studimit.

Lexo në faqen pasardhëse...

Workshop-et për riformatimin e programeve të studimit dhe ofertës së re akademike



Workshop-et u organizuan nga Zv Rektori për mësimin Prof. Dr. Ilir Kapaj, Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë në UBT (DVBSC) dhe koordinatorët e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi u organizuan 30 workshop-e për të gjitha programet e reja të studimit që UBT do të ofrojë për vitin akademik 2026-2027 e në vazhdim. Në analizë u përfshinë 12 programe të ciklit të parë Bachelor, 16 programe të ciklit të dytë Master i Shkencave, 1 (një) program studimi Master Ekzekutiv dhe 1 (një) programin e integruar i ciklit të dytë Mjekësisë Veterinare, duke përfaqësuar të gjithë ofertën akademike të universitetit.



Ky proces përbën një nga etapat më të rëndësishme të transformimit të ofertës akademike të UBT-së, e cila është riformatuar tërësisht në bashkëpunim dhe nën supervizionin akademik të BOKU University (University of Natural Resources and Life Sciences, Vienna). Përmes këtij partneriteti strategjik, universiteti ka harmonizuar programet e studimit me standardet më të mira evropiane, duke ndërtuar një ofertë akademike moderne, të orientuar drejt cilësisë, ndërkombëtarizimit dhe kërkesave të tregut të punës.




Një pjesë qendrore e procesit ishte prezantimi i secilit modul nga pedagogu përgjegjës. Çdo pedagog argumentoi përmbajtjen e modulit, objektivat, kompetencat që synohen të zhvillohen te studentët, metodologjinë e mësimdhënies dhe format e vlerësimit, si edhe eksperiencën akademike, kërkimore dhe profesionale që e bën atë të aftë dhe me kompetencat e duhura për zhvillimin e modulit përkatës. **Lexo më shumë...**




Një Ujë – Një Shëndet: UBT sjell ekselencën kërkimore në dialogun global për ujin dhe shëndetin

Duke përfaqësuar UBT-në në këtë forum global, Prof. Dr. Erinda Lika, Zëvendësrektore për Shkencën dhe Projektet në UBT, mori pjesë si përfaqësuese e UBT në workshop-in “Rimendimi i Ujit dhe Shëndetit: Integrimi i konceptit One Water dhe One Health”, duke kontribuar me studimin e rastit nga Shqipëria në perspektivën bujqësore dhe duke paraqitur qasje kërkimore mbi ndërlidhjet komplekse ndërmjet cilësisë së ujit, produktivitetit bujqësor, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, shëndetit të kafshëve dhe mirëqenies njerëzore.

Ky moment shënon angazhimin e parë të UBT-së në një rrjet prestigjioz global të fokusuar në ujin, shëndetin, bujqësinë dhe qëndrueshmërinë, duke dëshmuar kapacitetin e universitetit për të kontribuar në diskutimet shkencore ndërkombëtare përmes kërkimit ndërdisiplinor, inovacionit dhe bashkëpunimit kuptimplotë. **Lexo më shumë...**





UBT prezanton Laboratorin e ri për analizimin e vajit të ullirit dhe vajrave vegjetale

Tashmë vaji i ullirit do të analizohet në UBT. Në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit u zhvillua sot aktiviteti përmbyllës i projektit “Ngritja e Labororit të Analizimit të Vajit të Ullirit dhe Vajrave Vegjetale”, një investim i rëndësishëm në infrastrukturën kërkimore dhe laboratorike të universitetit, i mbështetur nga fondet e AKKSHI-t.

Në aktivitet mori pjesë edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, së bashku me drejtues, pedagogë, kërkues shkencorë dhe studentë të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit. Gjatë prezantimit u pasqyruan rezultatet e projektit, i cili është realizuar në periudhën 2024–2026, me koordinator Prof. Dr. Kapllan Sulaj.

Laboratori i ri synon të forcojë kapacitetet kërkimore dhe mësimdhënëse të UBT-së në fushën e teknologjisë ushqimore, duke krijuar mundësi për analiza të avancuara fiziko-kimike të vajit të ullirit dhe vajrave të tjerë vegjetalë. Ai do të shërbejë si një platformë moderne për zhvillimin e kërkimit shkencor, mbështetjen e studimeve master dhe doktoraturë, si dhe për ofrimin e shërbimeve laboratorike për industrinë agro-ushqimore.

Gjatë aktivitetit u prezantuan gjithashtu pajisjet instrumentale të instaluar në laborator, procesi i realizimit të projektit dhe ndikimi që kjo infrastrukturë pritet të ketë në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, trajnimin e studentëve dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët e sektorit. **Lexo më shumë...**





Programet e reja në UBT për bujqësinë e së ardhmes

Bujqësia e së ardhmes dhe programet e reja të UBT, me synimin formimin e ekspertëve të fushës ishin fokusi i një emisioni televiziv në Ora News, ku të ftuar ishin Prof. Dr. Seit Shallari, Dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, si dhe Fatos Huqi e Xhulio Sema, asistent lektorë, të cilët ndanë vizionin e universitetit për modernizimin e arsimit bujqësor, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë shqiptare, në kuadër të procesit të integritimit në BE.

Asistenti lektor Xhulio Sema u ndal te rëndësia e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe roli që kërkimi shkencor luan në procesin e integritimit evropian. Ai nënvizoi se UBT është e angazhuar në studime doktorature në bashkëpunim me universitete në Gjermani dhe me Universitetin BOKU të Vjenës, të fokusuar në menaxhimin e burimeve ujore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Sipas Semës, në kuadër të këtij bashkëpunimi po implementohet një model teknologjik i përdorur në Gjermani, Austri dhe Luksemburg, i cili synon të aplikohet edhe në Shqipëri për monitorimin e cilësisë së ujërave dhe menaxhimin e baseneve ujore. Këto projekte lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat e Kapitullit 27 për mjedisin.

Nga ana tjetër, asistenti lektor Fatos Huqi u fokusua te potenciali i bujqësisë shqiptare për t'u bërë më konkurruese në tregun evropian. Sipas tij, Shqipëria duhet të orientohet drejt produkteve ku gëzon avantazhe natyrore dhe mund të krijojë vlerë të shtuar, duke shfrytëzuar klimën e favorshme, pozicionin gjeografik dhe biodiversitetin e pasur. **VIDEO E PLOTË**



UBT - World Vets, bashkëpunim për shërbimet veterinare

Aktiviteti mbledhi në auditor studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, të cilët patën mundësinë të njiheshin nga afër me eksperiencën dhe kontributin e kësaj organizate ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve veterinare në mbarë botën.

Gjatë leksionit, përfaqësuesit e World Vets prezantuan punën e tyre në dhjetëra vende të botës, duke ndarë njohuri dhe praktika mbi shërbimet veterinare në terren, sigurinë në anestezi, fushatat e sterilizimit të kafshëve dhe teknikat praktike që përdoren në misionet e tyre ndërkombëtare. **Lexo më shumë...**



Fushata veterinare vullnetare në Tropojë

Universiteti Bujqësor i Tiranës mori pjesë në fushatën vullnetare veterinare "Strays of Albania – Safe Paws", një iniciativë që bashkon ekspertë, studentë dhe organizata partnere për sterilizimin, kastrimin dhe vaksinimin e qenve dhe maceve në qytetin e Tropojës.



Fushata synon të kontribuojë në menaxhimin e popullatës së kafshëve endacake, përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe rritjen e sigurisë shëndetësore për komunitetin. Aktivitetet nisën në ambientet e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të UBT-së. Më 13 qershor pjesëmarrësit u nisën drejt Tropojës, ku u zhvilluan trajnimet për procedurat e kapjes, regjistrimit, ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimit post-operator të kafshëve. **Lexo më shumë...**



UBT shënon sukses në programin doktoral ndërkombëtar



Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, mori pjesë si anëtar i komisionit vlerësues në mbrojtjen e doktoraturës së Aleksandër Peqinit në Universitetin Justus Liebig Giessen (JLU), Gjermani. Doktoratura, e realizuar në kuadër të modelit Cotutelle mes UBT-së dhe JLU-së, përfaqëson një nga sukseset e para të këtij bashkëpunimi ndërkombëtar.

Studimi trajtoi ndotjen e burimeve ujore dhe zhvillimin e metodave inovative me kosto të ulët për trajtimin e ujit, duke kontribuar në kërkimin shkencor dhe përafrimin me standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. **Lexo më shumë...**



Projekti UBT-BOKU 2030

Ekipi i UBT, vizitë në Vjenë



Vizita u realizua në kuadër të projektit të përbashkët që Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe BOKU University vijojnë prej dy vitesh, me fokus forcimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor ndërmjet dy institucioneve. Një nga objektivat kryesore të vizitës ishte konkretizimi i mundësive për përfshirjen e profesorëve dhe ekspertëve të BOKU University në procesin mësimor të Universitetit Bujqësor të Tiranës, përmes leksioneve të ftuara, moduleve të specializuara dhe formave të tjera të bashkëpunimit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. **Lexo më shumë...**





Ekspertë evropianë të pyjeve leksion në UBT

Në kuadër të programit Erasmus+, Fakulteti i Shkencave Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës organizoi një aktivitet akademik për shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave ndërkombëtare. Prof. Dr. Ing. Tomáš Kušta nga Czech University of Life Sciences Prague mbajti një leksion mbi menaxhimin e faunës së egër dhe gjuetisë në Republikën Çeke, duke prezantuar politikat, praktikat dhe sfidat kryesore të këtij sektori. **Lexo më shumë...**



Studentë të Masterit nga ULCO, Francë vizitë në UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës mirëpriti studentë të nivelit Master nga ULCO (Université du Littoral Côte d'Opale), Francë.



Zv.rektorja për Marrëdhëniet me Institucionet dhe Publikun, Prof. Asoc. Romina Koto u prezantoi studentëve fakultetet, programet e studimit dhe drejtimet strategjike të universitetit. Më pas, Prof. Dr. Alketa Grepcka, nga Zyra e Projekteve dhe Zhvillimit, prezantoi programet e mobilitetit ndërkombëtar.

Një nga ndalesat ishte Laboratori i Smart Agriculture i Hortikulturës, ku studentët u pritën nga Prof. Dr. Endrit Kullaj.

Vizita vijoi në laboratorët e analizës së vajit të ullirit dhe të tokës. **Lexo më shumë...**



Studentët e Inxhinierisë Pyjore, praktikë në Tropojë dhe Luginën e Valbonës



Nga auditorët tek zemra e Alpeve shqiptare. Studentët e vitit të parë dhe të dytë të Inxhinierisë Pyjore në UBT zhvilluan një praktikë mësimore në terren në zonën e Tropojës dhe Luginës së Valbonës, në kuadër të moduleve Botanikë Pyjore dhe Kontrolli i Erozionit.

Gjatë dy ditëve të aktivitetit, studentët patën mundësinë të njihen nga afër me pasuritë natyrore dhe ekosistemet pyjore të një prej zonave më të rëndësishme të vendit për biodiversitetin dhe vlerat mjedisore. Praktika synoi të forcojë njohuritë teorike të fituara në auditor përmes vëzhgimeve dhe analizave të drejtpërdrejta në terren. **Lexo më shumë**



“Receta e gjyshes është moderne”, studentët promovojnë produktet vendase



Studentët e programit të Masterit Profesional “Menaxhim i Turizmit Rural” dhe të programit profesional dyvjeçar “Agroturizëm dhe Mikpritje” në UBT organizuan një aktivitet të veçantë kushtuar promovimit të produkteve tradicionale dhe identitetit kulturor shqiptar, si pjesë e lëndës “Produktet e Territorit”.

Aktiviteti kishte si qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë që produktet vendase kanë në zhvillimin ekonomik të komuniteteve rurale, në forcimin e turizmit dhe veçanërisht të agroturizmit. Përmes kësaj detyre, studentët u nxitën të eksplorojnë dhe promovojnë produkte autentike tradicionale. **Lexo më shumë...**

